



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

**ZYRA E INSPEKTORIT TË LARTË TË DREJTËSISË
INSPEKTORI I LARTË I DREJTËSISË**

Nr. 173/ prot.

Tiranë, më 05. 05. 2023

3

NJOFTIM ME SHPALLJE

TË VENDIMIT NR. 173/1, DATË 20.04.2023 TË INSPEKTORIT TË LARTË TË DREJTËSISË, “PËR PËRFUNDIMIN E PROCEDURËS SË VERIFIKIMIT PA NJË VENDIM PËRFUNDIMTAR PËR GJYQTAREN ZNJ. F.H., LIDHUR ME ANKESËN E PARAQITUR NGA SHTETASJA ZNJ. LULJETA HOXHA”

Inspektori i Lartë të Drejtësisë ka marrë në shqyrtim ankesën e znj. Luljeta Hoxha me nr. 293 prot., datë 28.01.2021, ndaj veprimtarisë gjyqësore të magjistrates znj. F.H., gjyqtare në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Durrës dhe me vendimin nr. 173/1, datë 20.04.2023 të Inspektorit të Lartë të Drejtësisë, “Për përfundimin e procedurës së verifikimit pa një vendim përfundimtar për gjyqtaren znj. F.H., lidhur me ankesën e paraqitur nga shtetasja znj. Luljeta Hoxha”, bazuar në nenet 95 të ligjit 44/2015 “Kodi i Procedurave Administrative i Republikës së Shqipërisë”, 117, 122 të ligjit nr. 96/2016 “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar, dhe nenin 214 të ligjit nr. 115/2016 “Për organet e qeverisjes së sistemit të drejtësisë”, i ndryshuar, ka vendosur përfundimin e procedurës së verifikimit pa një vendim përfundimtar. Vendim duhet t’i njoftohet ankuesit, brenda 5 ditëve nga marrja e tij. Kundër këtij vendimi, ankuesi mund të paraqesë ankim në Këshillin e Lartë Gjyqësor, brenda 1 jave nga marrja e njoftimit të tij.

Meqenëse nuk është arritur njoftimi i vendimit në adresën e komunikuar nga ankuesi, bazuar në parashikimet e nenit 162 të ligjit nr. 44/2015 “Kodi i procedurave administrative i Republikës së Shqipërisë”, Inspektori i Lartë i Drejtësisë, bën njoftimin publik të vendimit, nëpërmjet kësaj shpallje për një afat 10 ditor. Njoftimi publik vlerësohet i kryer pas 10 ditëve nga data e shpalljes.

Njoftimi i vendimit me shpallje publikohet:

- një kopje në këndin e njoftimeve të Zyrës së Inspektorit të Lartë të Drejtësisë;
- një kopje në këndin e njoftimeve të Bashkisë Durrës, sipas adresës së lënë nga ankuesi: Lagjja nr. 12;
- në faqen zyrtare të internetit të Zyrës së Inspektorit të Lartë të Drejtësisë: www.ild.al.

Shpalljet që do të afishohen në ambientin e bashkisë përkatëse, do të hartohen në dy kopje me qëllim që një prej tyre të kthehet në Zyrën e Inspektorit të Lartë të Drejtësisë me nënshkrimin dhe datën që shpallja u afishua.

SEKRETAR I PËRGJITHSHËM

Dëshira Pasko

